



Enciklikë e Njëqindvjetorit

*U gëzova kur më thanë: le të shkojmë në shtëpinë e Zotit”
Psalmi 122*

Viti 2008 shënon një shekull në shërbesën e apostolatit Orthodox Shqiptar në Amerikën e Veriut. Për herë të parë, shërbesat hyjnore u kryen në shqip për t'i shërbyer të krishterëve orthodoxë në gjuhën e tyre, kur u organizua famullia e parë në Boston. Prifti ynë i parë, më vonë hierark, Theofan Stilian Noli, filloi në vitin 1908 një shërbesë të jashtëzakonshme dhe shumëplanëshe që i shërbeu në mënyrë të mrekullueshme popullit të tij këtu dhe në atdhe.

Gjatë dekadave që pasuan, kemi parë ngritjen e juridiksioneve të shumtë, ndërhyrjen e revolucioneve sekularë jashtë si edhe efektet e tyre tek besimtarët këtu; kryqëzimin e shqyrtimeve politike dhe patriotike që sfiduan komunitetet tona dhe që shpesh i përçanë ato. Si në të gjitha përpjekjet temporale, kemi përjetuar dhimbje dhe triumfe, humbje dhe epifanira. Gjatë dhjetë dekadave të fundit, ashtu siç kemi mësuar shumë gjëra, po ashtu nuk kemi arritur ta përqafojmë njëri-tjetrin më me shumë dëshirë. Ndarjet tona i detyrohen po aq rrethanave sa edhe vetes tonë. Ne kemi bashkëndarë përvojën tonë me të tjerët, meqenëse ne jemi si të veçantë ashtu edhe të ngjashëm me të tjerët. Në kërkim të gjetjes së rrugëve për të kapërcyer dallimet tona kemi qenë të pasionuar dhe të arsyeshëm, të ashpër dhe fleksibël. Por kohët e mosunitetit nuk i kanë megjulluar kurrë dhe as nuk i kanë ndaluar paraardhësit tanë për të kryer rolet e tyre peshkopolë para Krishtit, për të ecur përpara, për të mësuar, pagëzuar dhe për t'i shërbyer atyre që na janë besuar neve dhe të parëve tanë.

Në këtë kohë, ne përkujtojmë me lutje hierarkët dhe udhëheqësit tanë, Peshkop Theofanin (Noli), Peshkop Markun (Lipa), Peshkop Stefanin (Laska) si edhe shumë priftërinj dhe laikë, burra dhe gra, të grigjës sonë besimtare, të cilët kanë fjetur para nesh. I përjetshëm qoftë kujtimi i tyre!

Pavarësisht nga sfidat e shumta që të gjithë ne kemi hasur, kleri dhe besimtarët kanë qenë gjithmonë të përqëndruar në detyrën e tyre kryesore: shpalljen e Ungjillit dhe shpëtimin që ata arrijnë nëpërmjet veprës shpërblyese të Zotit dhe Shpëtimtarit tonë Jisu Krisht. Ne e përkujtojmë dhe e kremtojmë këtë moment të njëqindvjetorit me përlësi: duke sjellë ndër mend gjithçka që ka ndodhur më parë me shpresën që do të mbetemi të vërtetë në aspiratat dhe kërkesat e brezave të ardhshëm, përsëri për të qenë të shpëtuar, të ushqyer dhe të rritur. Si ata, të cilët nga Hiri i Perëndisë u është besuar të baritojnë komunitetet tona, ne përfitojmë nga ky rast për të dëshmuar së bashku dhe për të thënë së bashku me dashuri dhe shpresë, se jemi një në Zotin Tonë, një në Eukaristi dhe një në mendimin se ne e lëmë këtë ditë një vend më të mirë për brezat që do vijnë. “Sa mirë është që vëllezërit të banojnë bashkë në unitet.” Psalmi 133

Të Dielën e Ndjesës, Ditën e 9-të të Marsit, në Vitin e 2008 të Zotit Tonë, në Katedralen e Shën Gjergjit në Boston, Massachusetts.

+NIKON

Bishop of Boston, New England and
Albanian Orthodox Archdiocese in
America

+ILIA

Bishop of Philomelion
The Albanian Orthodox Diocese of
America